



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 2817

Tirane, date 24.3.2015

Drejtuar: ZOTIT YLBER DODA
SHOQERIA "YLBERI" SH.P.K
RRUGA "IRFAN TOMINI", VILA 58

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr.484 date 02.08.1999.

I nderuar zoti Doda,

Shoqëria "Ylberi" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.484 date 02.08.1999, për mineral kromi ne objektin "Fushe Lope" Martanesh, Bulqize , ne Qarkun Dibër.

Me urdhër te Ministrit te Energjisë dhe Industrisë nr. 329 date 22.10.2014 "Për kontrollin e realizimit te programit te zhvillimit për lejet minerare ne rajonin e Martaneshit, rrethi Bulqize, Qarku Dibër" është ngritur grupi i punës i përberë nga specialiste te Drejtorisë se Politikave dhe Zhvillimit te Minierave pranë kësaj ministrie, Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore, Repartit te Inspektim Shpëtimit te Minierave, i cili ka kryer kontrollin ne rajonin e përcaktuar ne Urdhrin ne fjale ne ditët e para te muajit nëntor te vitit 2014.

Pas kontrollit është hartuar raporti për secilën leje me propozimet përkatëse, ne zbatim te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar dhe akteve nënligjore qe kane dale ne zbatim te tij.

Grupi i Punës për lejen minerare nr.484 date 02.08.1999 qe zotërohet nga shoqëria "Ylberi" shpk, ka propozuar te revokohet sepse: "Subjekti nuk ka zbatuar ne kohe detyrimet për investimet e projektit te zhvillimit minerar te miratuar ne vitin 2007 ne këshillin Teknik te AKBN-se për zhvillimin e aktivitetit minerar".

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 “Minerar te Shqipërisë” i ndryshuar, i cili është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve te tij edhe për lejet e dhëna përpara datës se hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Shkaku për te cilën është propozuar nga grupi i punës për revokimin e lejes nr.484 date 02.08.1999, është ne përputhje me germen “f” te nenin 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr.484 date 02.08.1999, për mineral kromi ne objektin “Fushe Lope” Martanesh, Bulqize , ne Qarkun Dibër.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.484 date 02.08.1999.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

